



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

SEKTORI I TEKSTILEVE



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

PESHA NË EKSPORT

KONTRIBUTI NË PUNËSIM

RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT

PROCESET E PUNËS, PRODUKTET DHE SHËRBIMET

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

AVANTAZHET E SEKTORIT

KOMPANI TË RËNDËSISHME TË SEKTORIT

HISTORI SUKSESI

MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

E ARDHMJA E SEKTORIT

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Para vitit 1990, industria e tekstileve dhe konfeksioneve ishte degë kryesore e industrisë së lehtë dhe konsiderohej sektor i rëndësishëm i ekonomisë së vendit. Rreth 68% e të punësuarve në këtë sektor, përbëhej nga gratë. Kryesisht, ishte e fokusuar në prodhimin e leshit, mëndafshit dhe pambukut, si dhe në përpunimin e fibrave natyrore, artificiale dhe sintetike për të prodhuar pëlhura, stof, trikotazhe, penjë dhe artikuj të tjerë.

Pas vitit 1990, modeli i prodhimit ka ndryshuar së bashku me metodologjinë dhe teknologjinë e prodhimit. Në periudhën 1998-2008 lindi dhe u zhvillua ,me hapa të shpejtë, ajo që sot njihet me termin industria “Fason”. Gjatë kësaj periudhe, prodhuesit shqiptarë operonin, fillimisht, me vendet fqinje Itali dhe Greqi, për kryerjen e një ose disa proceseve të punës. Gjatë dekadës së fundit, falë eksperiencës së krijuar ndër vite dhe investimit në teknologji, industria tekstile ka zgjeruar hartën e vendeve bashkëpunëtoare, ka rritur volumin e kontratave dhe, tashmë, është e orientuar drejt prodhimit me cikël të mbyllur.

Aktualisht, industria e veshjeve dhe tekstileve në vendin tonë operon me tre lloje kompanish:

- kompani që prodhojnë dhe eksportojnë të gjithë produktin e tyre (77%);
- kompani që prodhojnë dhe eksportojnë pjesërisht produktin (18%);
- kompani që prodhojnë për treg të brendshëm (5%).

Struktura e pronësisë së kompanive, në sektorin e tekstileve, është e formës 79.5% shqiptare, 16.5% bashkëpronësi dhe 3.5% e huaj.



STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

Numri i kompanive që operojnë në sektorin e tekstileve, në vend, është rritur çdo vit. Të dhënat zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit ndër vite, për subjektet që ushtrjnë aktivitet në sektorin e industrisë së prodhimit dhe përpunimit të tekstileve:

438

subjekte aktive
në vitin 2015

684

subjekte aktive
në vitin 2020

Numri më i madh i kompanive është i përqëndruar, kryesisht, në qytetet e mëdha, si: Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Elbasan, Berat dhe Vlorë.



Punësimi i përgjithshëm	57.330 të punësuar
Paga mesatare mujore	31,500 lekë
Numri total i ndërmarrjeve aktive	684
Eksportet	38% e eksporteve shqiptare

Gjatë periudhës 2016-2020 volumi i eksporteve të tekstileve ka vijuar, si më poshtë:

Periudha	2016	2017	2018	2019	2020
Eksportet në milion lek	26,637	30,266	35,519	30,999	26,888

PESHA NË EKSPORT

Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP-ja vjetore) e Shqipërisë është rreth 15 - 15.5 bilionë euro, ku eksportet zënë një pjesë të rëndësishme të saj, rreth 77%.

Sipas të dhënave zyrtare të Doganës Shqiptare, **tekstilet zënë rreth 38% të vlerës totale të eksporteve**. Ato përbëjnë 1 nga 3 grup-mallrat kryesore të eksportit (tekstilet, lëkurë-këpuca dhe lëndët minerale). Referuar të dhënave të INSTAT, peshën më të madhe të eksporteve e zë Italia me 64%, më pas vijon Gjermania me 14% dhe pjesa tjetër ndahet midis: Francës 5.5%, Greqisë 7% dhe përqindje më të vogël zënë shtetet, si: Danimarkë, Hollandë, Suedi, Spanjë, etj.

Referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë, rënia e vlerës së eksporteve, gjatë 2 viteve të fundit, lidhet drejtpërdrejt me situatën e shkaktuar nga pandemia COVID 19 dhe rënia e valutës euro gjatë periudhës 2019-2020.

KONTRIBUTI NË PUNËSIM

- Sipas të dhënave të INSTAT dhe informacionit të zyrave të punës, numri i të punësuarve në sektorin e veshjeve dhe tekstileve është 57.330 persona.
- Moshë mesatare e fuqisë punëtore, të punësuar në sektorin e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve, është 32 vjeç. Paga mesatare, në këtë sektor, është 31,500 lekë në muaj.
- Sipas nivelit të arsimimit, të punësuarit në sektorin e tekstileve ndahen në 5% me arsim universitar, 20% me arsim të mesëm dhe 75% me arsim fillor.
- Rreth 95% e të punësuarve, në këtë sektor, përbëhet nga gratë dhe vetëm 5% nga meshkujt.
- Rreth 97% e punëdhënësve, në sektorin tekstile dhe veshje, aplikojnë për programet e nxitjes së punësimit, në bashkëpunim me zyrat e punës dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT

Sektori i industrisë tekstile luan një rol vendimtar në ekonominë dhe mirëqenien sociale, në disa rajone të vendit. Ky sektor zë peshën më të madhe në eksport, pasi përfaqëson rreth 38% të totalit të eksporteve dhe 45% të forcës punëtore në industrinë përpunuese. Prej 2 dekadash, rritja e këtij sektori ka vazhduar me hapë të sigurt dhe kjo dëshmohet nga rritja e numrit të subjekteve që operojnë në këtë sektor, rritja e numrit të të punësuarve brenda sektorit, rritja në volume dhe vlerë e produkteve tekstile të eksportuara, si dhe zgjerimi i tregjeve të reja të eksportit.

Një tregues i rëndësishëm që dëshmon rritjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit është dhe vlera e importit të makinerive dhe pajisjeve teknologjike që përdoren në industrinë e tekstit (64.9 miliardë lekë, gjatë vitit 2019).

PROCESET E PUNËS, PRODUKTET DHE SHËRBIMET

Sektori i tekstileve në Shqipëri operon në dy forma:

Prodhim me porosi, me një ose disa procese (kur kompanitë shqiptare kontrahohen vetëm për kryerjen e një ose disa proceseve të punës dhe pjesa tjetër, e finalizimit të produktit, kryhet jashtë vendit).

Prodhim me cikël të mbyllur (kur kompania shqiptare prodhon dhe eksporton produkte me cikël të plotë). Produktet e përfunduara mund të dalin në treg të brendshëm ose mund të eksportohen në tregje të huaja duke dëshmuar origjinën e produktit (Made in Albania).

Në 5 vitet e fundit, vihet re një rritje e numrit të kompanive që operojnë me cikël të mbyllur. Në vitin 2015, rreth 20% e kompanive shqiptare operonin me cikël të mbyllur, ndërsa në vitin 2020 vlera ka arritur rreth 43%.

Aktualisht, në vendin tonë, njihen 5 lloje të modeleve të biznesit të tekstileve:

1. M* (Prodhim);
2. CM (Prerje dhe prodhim);
3. CMT (Prerje, prodhim dhe rregullim);
4. FP (Paketa e plotë);
5. OB (Marka e vet).



Produktet kryesore që prodhohen në industrinë tekstile, në Shqipëri, janë:

Veshjet e brendshme
(33%)

Uniformat e punës
(28%)

Veshje të stileve të ndryshme
(25%)

Tekstile të tjera
(14%)

Makineritë dhe pajisjet teknologjike që përdoren në industrinë tekstile në Shqipëri, janë 100% të importuara nga jashtë. Vendet kryesore nga të cilat importohen këto makineri janë vendet e BE-së dhe Kina.

*M - Make;

FP - Final Product

CM - Cut&Make

OB - Original Brand

CMT - Cut,Make&Trim

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

Duke qenë se pjesa më e madhe e tekstileve që prodhohet në vendin tonë shkon për eksport, detyrimisht, këto produkte certifikohen në bazë të rregullave, standardeve dhe kërkesave që paraqet tregu final ku do të tregtohen.

Certifikimet me të kërkuara të tekstileve në vendin tonë, janë:

1. **ISO** (International Organization for Standardization). Standardet ISO, më të përdorura në vendin tonë, janë standardi ISO 9001 dhe ISO 14001 që lidhen përkatësisht, me certifikimin e cilësisë së produktit dhe certifikimin e menaxhimit të mjedisit të punës.
2. **GOTS** (Standardi Global i Tekstilit Organik). Ky është standardi kryesor i përpunimit të tekstilit për fijet organike, duke përfshirë kriteret ekologjike dhe sociale, mbështetur nga certifikimi i pavarur i të gjithë zinxhirit të furnizimit me tekstil.
3. **OEKO-TEX**: është një sistem i pavarur testimi dhe certifikimi për kimikatet, ngjyruesit dhe ndihmësit e përdorur për prodhimin e tekstileve. Ky proces analizon nëse produktet kimike përbushin kërkesat specifike në lidhje me qëndrueshmërinë, sigurinë, pajtueshmërinë dhe me rregullat ligjore në fuqi.

Sipas Shoqatës Kombëtare Proeksport Albania, 96% e kompanive tekstile, në vendin tonë, zotërojnë të paktën një certifikim dhe rreth 54% e tyre zotërojnë dy ose më shumë certifikime, në varësi të nevojave të tyre.

AVANTAZHET E SEKTORIT



Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin dhe rritjen e industrisë tekstile, janë:

Pozicioni gjeografik i vendit tonë (ofron mundësi të ndryshme transporti, akses si në rrugë detare ashtu dhe në rrugë tokësore).

Kuadri ligjor i konsoliduar në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Kosto të ulëta të transportit dhe infrastrukturë të përshtatshme.

Kosto e lirë e punës në vendin tonë, në raport me vendet e tjera.

Numër relativisht i lartë i fuqisë punëtore, e gatshme për të punuar në këtë sektor.

Investim i lartë i kompanive shqiptare në makineri dhe pajisje teknologjike, që ndihmon në plotësimin e kërkesave specifike të tregut.

KOMPANI TË RËNDËSISHME TË SEKTORIT

Bazuar në shtrirjen gjeografike, varietetin e produkteve, numrin e punonjësve dhe volumin e eksporteve, disa kompani të rëndësishme të sektorit të industrisë tekstile, janë:

- | | |
|------------------------------|------------------------------|
| 1. Naber Konfeksion - Durrës | 6. Madish SHPK - Shkodër |
| 2. Kler SHPK - Tiranë | 7. AFM Distribution - Tiranë |
| 3. Marlotex SHPK - Berat | 8. The Blue Star - Durrës |
| 4. ALV Tex - Vlorë | 9. Spaniel SHPK - Korçë |
| 5. Intex - Berat | 10. Alitex SHPK - Fier |

HISTORI SUKSESI

Midis kompanive të shumta që kanë nisur biznesin e tyre nga zero dhe sot janë kthyer në biznese të suksesshme, që operojnë në treg global, vlen të përmendim kompaninë OLA 1, e cila ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1991. Sot, kjo kompani zotëron një fabrikë të standardeve europiane për sa i përket ambienteve të biznesit, makinerive, pajisjeve teknologjike dhe cilësisë së produkteve që hedh në treg. Kompania numëron rreth 185 produkte që i prodhon me cikël të plotë, në masa, ngjyra dhe karakteristika të ndryshme, sipas kërkesave dhe që i tregton në tregun vendas dhe tregun europian. Kompania operon nëpërmjet shitjeve me pakicë në katër pikat e shitjes në Tiranë, shitjeve elektronike në të gjithë botën dhe nëpërmjet shitjeve me shumicë, sipas kontratë porosive, me dy kompani bashkëpunëtoare në Gjermani dhe Suedi.



MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

Sektori i industrisë tekstile ka qenë në fokus të vazhdueshëm të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare. Me miratimin e paketës "Fason" në vitin 2014, u bë i mundur realizimi i një sërë masash dhe kërkesash të këtij sektori, ku ndër më të rëndësishmet përmendim:

- Rimbursimi i TVSH-së së subjekteve brenda 30 ditëve (ka qenë pa afat);
- Shkurtimi i procedurave doganore (afati i mëparshëm ka qenë brenda javës dhe është bërë 4-5 orë);
- Kreditim i menjëhershëm i TVSh-së së karburantit;
- Mundësi trajnimi për punonjësit e industrisë tekstile, i mundësuar nga bashkëpunimi me qendrat e trajnimeve profesionale;
- Ambiente biznesi me qira 1 euro (sipas kushteve specifike).

AIDA nëpërmjet shërbimeve të saj ka mbështetur financiarisht rreth **64** subjekte që ushtrojnë aktivitetin në këtë sektor.

Mbështetja financiare është kryer nëpërmjet fondeve që AIDA ka menaxhuar dhe që kanë pasur përputhshmëri me sektorin (Fondi i Konkurrueshmërisë; Fondi i Inovacionit; Fondi Start Up).

Shërbime të tjera që AIDA ka ofruar dhe ofron në mbështetje të biznesit vendas, janë:

Analiza sektoriale të tregut dhe sektorët e mundshëm për investime.

Këshilla për gjetjen e pronave dhe vendndodhjeve të përshtatshme (në rastet kur kompanitë synojnë të zgjerohen ose të nisin një investim nga e para).

Ndihma në identifikimin e projekteve të ardhshme dhe ekzistuese të investimeve në Shqipëri.

Identifikimi i eksportuesve vendorë, partnerëve të biznesit ose kontakteve institucionale.

Organizimi i aktiviteteve ndërmjetësuse dhe panairove kombëtare dhe ndërkombëtare.

Grantet financiare dhe mundësitë e financimit nga projekte të ndryshme të BE-së, që kanë në fokus nxitjen dhe mbështetjen e prodhuesve shqiptarë për aksesin në tregje të reja.



Business Support on Your Doorstep

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), si koordinatore e projektit Enterprise Europe Network (EEN-Albania), ofron shërbime dhe mundësi për të gjitha sipërmarrjet që kërkojnë tregje të reja ndërkombëtare.

Enterprise Europe Network (EEN), vazhdimisht, informon mbi thirrje të projekteve dhe iniciativa drejtuar bizneseve në sektorin e tekstilit dhe modës. Nëpërmjet shërbimeve të integruara, EEN mbështet sipërmarrjet, duke i bërë më të qëndrueshme dhe inovative me qëllim gjetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Këto shërbime përfshijnë dhe konsistojnë, në:

- Këshillim dhe mbështetje
- Partneritete ndërkombëtare
- Organizim dhe pjesëmarrje në aktivitete

Enterprise Europe Network, rrjeti më i madh në botë në mbështetje të sipërmarrjeve, me rreth 600 organizata mbështetëse, në më shumë se 60 vende të botës.

E ARDHMJA E SEKTORIT

Sektori i tekstileve, aktualisht, ka pësuar dy goditje të njëpasnjëshme, siç janë periudha e rënies së valutës euro dhe periudha e pandemisë Covid 19. Si pasojë, sfida kryesore e sektorit është vazhdimi i aktivitetit prodhues dhe tregtar, duke u përpjekur të ruajnë sa më shumë ecurinë pozitive të krijuar ndër vite. Përshtatja e aktivitetit prodhues me situatën e krijuar nga pandemia është një nga elementët kyç që po ndikon ndjeshëm në rikuperimin e pasojave të shkaktuara. Pas pandemisë, një pjesë e konsiderueshme subjektsh, kanë filluar të prodhojnë maska, kapele dhe produkte të tjera një përdorimshe, për të cilat ka nevojë tregu aktual.

Sipas ekspertëve të sektorit, pas kalimit të kësaj periudhe, si dhe kur gjithçka të jetë kthyer në normalitet, sektori i tekstileve duhet të synojë vazhdimisht arritjen e tre objektivave kryesore:

Orientimin e kompanive drejt prodhimit me cikël të mbyllur.

Diversifikimin e portofolit të eksporteve (pjesa më e madhe është e përqëndruar në Itali).

Përdorimin e teknologjive të reja dhe automatizimin e proceseve të punës.

Arritja e objektivave të mësipërme do të sjellë ndikim pozitiv në të ardhmen e sektorit, përkatësisht, në këto drejtime:

- Ndikon në rritjen e çmimit të produkteve dhe në përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e sektorit.
- Rrit qëndrueshmërinë e sektorit nëpërmjet zgjerimit të hartës së tregjeve të eksportit.
- Minimizon kostot e prodhimit dhe shkurton kohën e nevojshme për realizimin e porosive.



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001

